



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.218/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Vedat Poterqoi–Kryetar, znj.Nita Bejta-Referuese dhe znj.Vjosa Gradinaj Mexhuani, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Uni-Care” sh.p.k. -Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rezonancë Magnetike (MRI)”, me numër të prokurimit:70030-22-2159-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– “Spitali i Përgjithshëm”-Pejë ,me datën 09.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Uni-Care” sh.p.k. -Prishtinë kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rezonancë Magnetike (MRI)”, me numër të prokurimit:70030-22-2159-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– “Spitali i Përgjithshëm”-Pejë.

II.Mbetet në fuqi, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rezonancë Magnetike (MRI)”, me numër të prokurimit:70030-22-2159-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– “Spitali i Përgjithshëm”-Pejë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Uni-Care” sh.p.k. -Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës sipas nenit 31.5 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Uni-Care” sh.p.k. -Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë 23.06.2022 , me nr.218/22, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rezonancë Magnetike (MRI)”, me numër të prokurimit:70030-22-2159-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– “Spitali i Përgjithshëm”-Pejë.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,28,59,60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.06.2022 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt.04.06.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, i cili pretendon se është i përgjegjshëm: Ku thuhet se është e ndaluar që ti refuzohet oferta një operatori ekonomik ku ne një mënyrë ekuivalente i plotëson specifikat teknike të Aneksit 1 të DT, ku ne rastin tonë përveç se i plotësojmë ofrojmë dhe zgjidhje me të mirë dhe me kualitative, se bëhet fjalë për teknologji shumë më të avancuar FIBER OPTIC ndërsa ju kërkoni me kabëll. Shih Ilustrimet e teknologjisë me fiber optic çfarë imazhi ka ne raport me teknologjinë që e keni propozuar për kontratë teknologji me tela Fiber Optic është teknologji e pranuar botërisht dhe ka avantazhe në imazh deri në 40% më shumë se teknologjia e kablove (Channels).

Në pikën 2.11 keni thënë se nuk e plotësojmë prerjen 2D nga 0.1 në 0.5 mm. Të ju shpjegojmë 0.1 mm nuk luan rol në Kualitet apo në diagnostikim të sëmundjeve siç keni aluduar 0.5 mm është standard i rezolucionit në 2D dhe është mëse i mjaftueshëm për aplikacionet teknike për imazh me kualitet të lartë. Ndërsa kjo aparatura e bene të njëjtën në 3D ku prerja është 0.05mm. Në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar se Pajisja e prodhuesit Philips nuk e përmbush pikën 1.3 që behet fjalë për 2 konektor. Pajisja jone me 2 Konektori ofron të gjitha llojet e imazheve të kërkuara nga AK. Gjithashtu me 2 Konektor mund të behet i gjithë Trupi .

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në bazuar në aneksi 1 të FDT-se, ku janë përshkruar specifikimet teknike, si dhe bazuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **nëni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesa 2. Deklarata për specifikacionin teknik për mallrat e ofruara nga prodhuesi dhe katalogu i prodhuesit.	Evidenca 2. Ofertuesi është i obliguar që të dorëzojë një deklaratë të prodhuesit për specifikimet teknike të evidentuara dhe të kërkuara për pajisje me të cilën oferton (të evidentoj me PO ose JO për secilën specifikë teknike kërkuar, varësisht a e plotëson apo jo këtë specifikë), si dhe duhet bashkangjitet katalogu i prodhuesit për pajisjen me të cilën oferton ku OE është i obliguar që të nenvizojë specifikat teknike të kërkuara në katalog.
---	---

Gjithashtu, bazuar ne sqarimet shtese nga OE te interesuar para hapjes se ofertave sipas nenit 53 te LPP-se, te datës 21.04.2022, AK ka dhënë sqarime lidhur me numrin e kanaleve dhe pajisjeve percillese si në vijim:

Pvetja

1.Magnetic Resonance (MRI) 1.5 T with min : 95 Channel

Kërkojmë nga AK te hiqet ky Specifikim direkt i vetëm 1 prodhuesi dhe te mundësohet te ofrohen edhe teknologji tjera me te reja dhe jo min. 95 Channel * ky specifikim nuk ka rendësi ne kualitet te imazhit apo ne shpejtësi te ekzaminimit . Duhet te ndryshohet ne min. 24 channels ose platforma me te reja se kjo teknologji.

Përgjigje

Sistemi duhet të ketë mundësinë e konektimit për 95 kanale koilash e sipër njëkohësisht (jo me pak se 84 kanale)

Pvetie

3.Number of coil connectors on the patient table min: ≥ 4 connectors

A mund te ofrohet edhe me ≥ 2 connector sepse nuk kane ndikim ne ekzaminim dhe ne kualitet te imazhit . Dhe nuk mund te përdoren 4 connector ne praktik ne te njëjtën kohe

Përgjigje

Mund të ofrohet edhe me 2 konektor nese aparatura e ofruar ka mundësin qe me 2 konektor te ofroje mbi 80 kanali e siper .

Pvetja

Kërkesa 1. Autorizim i prodhuesit për rezonancë të plotë magnetike për shitje dhe servisim .

-Nuk ka prodhues ne bote qe bon Kafazin e MRI rezonancës, Chillerin , dhe Ups . Qysh keni mëndu autorizim nga prodhuesi për rezonancë magnetike te plote .

Përgjigje

OE duhet të ofrojnë Autorizimin nga Prodhuesi për shitje dhe servisim për produktin qe do të ofertoit ku ceket edhe modeli I ofertuar. Autorizimi kërkohet vetëm për njësinë kryesore Rezonancën Magnetike jo për pjesët përcjellëse të saja siç janë aksesoret , kabina UPS etj.

Pvetja

2. Kërkesa jone është qe ju duhet te ndani ne llot-e te veçanta : 1.Rezonanca magnetike
2.Cage(kafazi I rezonancës magnetike) 3.UPS i rezonancës magnetike 4.Chiller i Rezonancës magnetike

Pa këto kombinime nuk mund te funksionalizimet kjo pajisje. Dhe te gjitha këto janë prodhues te ndryshim .

Përgjigje

Ndarja në Lot nuk pranohet pasi qe të gjitha pjesët përcjellëse, aksesoret e Rezonancës Magnetike janë pjesë e një tërësie prodhues të tjerë apo i njëjti , prodhuesi i Rezonancës Magnetike duhet të siguroi aksesoret e vetë sipas Aneks -1 Specifikat të kërkuara dhe të na ofron si tërësi.

OE duhet të dëshmoi me një deklaratë nga prodhuesi i rezonancës magnetike ku thuhet se të gjitha pjesët përcjellëse , aksesoret e rezonancës janë përfshirë siç kërkohet në dosje të tenderit .

OE ankues edhe ne pretendimet e tij ne këtë ankese e dëshmon se nuk ka arrit te përmbushë specifikimin teknik - Aneksin 1 te FDT-se, pasi qe i mungon deklarata nga prodhuesi për specifikime teknike (OE ankues e nënshkruan dhe plotësona vet këtë deklaratë), ndërsa ne katalogun e ofruar nga prodhues për piken 2.11 te specifikacioni teknike Aneksi 1 te FDT-se, ka ofruar vlerën: 0.5 mm, ndërsa kërkesa ka qene ne vlerë: 0.1 mm, po ashtu piken 4.10 ka ofruar 2 connectors, sikurse ne përgjigjen më lartë të lejuar nga AK me 2 connectors, mirëpo nuk ka ofruar minimum prej mbi 80 kanale, por ka ofruar vetëm: 24 Channels, andaj bazuar edhe ne **nenin 72 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*, si dhe **nenin 39.8 te RRUOPP**, ku thotë:

Problemi	Si te vepohet?	Neni i LPP-se
<i>Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara</i>	<i>Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm</i>	69

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues për qellim ka pas vetëm eliminimin e ofertës tone dhe fare nuk e ka shikua katalogun e ofertës se rekomanduar sepse bazuar ne Katalogun e te rekomanduarit për kontrate ne lidhje me konektor i cili i posedon 4 konektor me më se shumti 16 chanals, qe bëjnë 64 Channels i cili nuk e plotëson këtë specifik . Shih Katalogun e te rekomanduarit :

MAX 4x16 Channels = 64 Channels

Technical specifications

MAGNETOM Sempra	
Field strength	1.5 Tesla
Bore size	60 cm / 1.97 ft
Helium consumption	Zero helium boil-off technology
Shimming	Passive and active
Maximum number of channels ¹⁾	96
Number of independent receiver channels that can be used simultaneously in one single scan and in one single FOV, each generating an independent parabol image	8, 16
Power consumption	Eco-Power technology
Magnet length	155 cm
System length ²⁾	171 cm / 5.61 ft
System weight (in operation) ³⁾	4.55 tons / 10,035.44 lbs
Minimum room size ⁴⁾	28 m ³ / 302 sq ft
Gradient strength	XF Gradients (30 mT/m @ 300 T/m/s)

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar katalogun nga prodhuesi dhe deklarata nga prodhuesi për specifikime teknike te nënshkruar, ashtu siç shihet Technical specifications: Maximum number of channels = 96

Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Operatori Ekonomik i Rekomanduar për Kontrate nuk e ka plotësuar përshkrimin e çmimit duke mashtrua AK ne lidhje me vendin e origjinës ku ne përshkrim te Çmimit e shkruan Prodhuesin SIEMENS GERMANY ndërsa ne EC Deklaratë te konfirmimitit është SIEMENS China.

EU DECLARATION OF CONFORMITY

Manufacturer

Siemens Shenzhen Magnetic Resonance Ltd.
Siemens MRI Center, Gaixin C. Ave., 2nd
Hi-Tech Industrial Park
518057 Shenzhen
PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA

Single Registration Number (SRN): n.a.

Authorized Representative

Siemens Healthcare GmbH
Henkestr. 127
91052 Erlangen
Germany

SRN Authorized Representative: n.a.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar EU Declaration of Conformity, ku ky dokumente është ne 3 (tri) faqe dhe ne faqen e trete ceket si ne vijim:

Manufacturing Sites

MAGNETOM Sempra

Material Number	Country of Origin	Manufacturer Site
10840815	made in China	Siemens Shenzhen Magnetic Resonance Ltd. Siemens MRI Center, Gaoxin C. Ave., 2nd, Hi-Tech Industrial Park 518057 Shenzhen PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA
10840816	made in Germany	Siemens Healthcare GmbH Magnetic Resonance (MR) Henkestr. 127 91052 Erlangen Germany

Ku është dëshmuar se vendi i prodhimit është Gjermani {Siemens Healthcare GmbH Magnetic Resonance (MR) Henkestr. 127, 91052 Erlangen Germany} me material numër: 10840816. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Operatori ekonomik i rekomanduar per kontratë nuk ka ofruar katalog te prodhuesit për Chiller, dhe as nuk ka ofru ISO dhe CE dhe asnje document te kërkuar .

Në Aneksin 1 te dosjes se Tenderit kërkohen këto Specifika :

1.29 Cooling system Active with external Fan

1.30 fan unit for the cooling System for outside temperatures of -25 up to 42 deg Celsius

Si ka mundësi qe AK te shpall fitues një operator ekonomik i cili nuk ka ofruar asnjë te dhënë ne lidhje me specifikat e kërkuara për sistemin e ftohjes i cili është mandator për këtë pajisje dhe kushton min 20.000- 30.000 Euro .

AK duke bërë shkeljen e nenit 59 e rekomandon për kontratën operator ekonomik i cili është i papërgjegjshëm për faktin se deklarata për specifika teknike e cila është shumë e dyshimtë sepse prodhuesi i cili e ka nënshkrua Deklaratën ne fjalë Siemens Healthcare nuk e prodhon as Dhomën e MRI (Cage) as UPS as Chiller . Per UPS ka ofrua katalogun e Prodhuesit WARTSILA ndërsa i nënshkruan Specifikat Siemens Healthcare.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe ne sqarimet shtese nga OE te interesuar para hapjes se ofertave sipas nenit 53 te LPP-se, te datës 21.04.2022, AK ka dhënë sqarime lidhur me pajisjet përcjellëse si në vijim:

Pvetja

2. Kërkesa jone është qe ju duhet te ndani ne llot-e te veçanta : 1.Rezonanca magnetike 2.Cage(kafazi I rezonancës magnetike) 3.UPS i rezonancës magnetike 4.Chiller i Rezonancës magnetike

Pa këto kombinime nuk mund te funksionalizohet kjo pajisje. Dhe te gjitha këto janë prodhues te ndryshëm .

Përgjigje

Ndarja në Lot nuk pranohet pasi qe të gjitha pjesët përcjellëse, aksesoret e Rezonancës Magnetike janë pjesë e një tërësie prodhues të tjerë apo i njëjti , prodhuesi i Rezonancës Magnetike duhet të siguroi aksesoret e vetë sipas Aneks -1 Specifikat të kërkuara dhe të na ofron si tërësi.

OE duhet të dëshmoi me një deklaratë nga prodhuesi i rezonancës magnetike ku thuhet se të gjitha pjesët përcjellëse, aksesoret e rezonancës janë përfshirë siç kërkohet në dosje të tenderit .

OE i rekomanduar për kontratës ka ofruar deklarata për specifika teknike te nënshkruar nga prodhuesi për pajisjet përcjellëse i cili garanton për sigurinë, funksionalitetin, e këtyre pjesëve nga prodhues te ndryshëm ashtu siç e potencon OE ankues, mirëpo një gjet e tille e ka lejuar AK përmes sqarimeve shtese te dhënë me datë 21.04.2022 te ngarkuar ne platformën elektronikë e-prokurimi. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se sa i përket shkeljeve te pretenduara te **nenit 1, 6, 7, 59 dhe 62 te LPP-se** konstatojmë faktin se autoriteti kontraktues ka bere shkelje te renda te dispozitave te nenit 59 sepse ne piken: II.1.10) te njoftimit për kontrate autoriteti kontraktues ka parapare qe Vlera e parashikuar e kontratës: 500 000,00 euro, ndërsa oferta e OE te rekomanduar për kontrate është mbi vlerën e parashikuar dhe sipas praktikave te Organit Shqyrtues te Prokurimit dhe nenit 62 te LPP-se oferta e OE te rekomanduar për kontrate nuk është dashur fare te futet ne vlerësim dhe e njëjta duhet te refuzohet, prandaj pavarësisht nga te gjeturat e cekura me larte lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate konstatojmë me përgjegjësi se nuk është dashur te vlerësohet oferta e te njëjtit për faktin se e ka tejkaluar buxhetin e parapare nga autoriteti kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe bazuar ne sqarimet e kërkuar nga ESH drejtuar ZPP te AK – Spitalit te Përgjithshëm – Pejë te datës 01.07.2022 dhe përgjigjet e pranuar ne po te njëjtën date, konsideroj se AK – Njësia e Kërkesës – ZPP nuk kanë vepruar ne harmoni te plotë me të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negociime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Vlera e parashikuar për këtë AK te prokurimit sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes se Tenderit e publikuar ne platformën elektronike e-prokurimi është: **500,000.00 Euro**, ndërsa AK – komisioni i vlerësimit me datën 07.06.2022 ka rekomanduar ZPP për dhënien e kontratës operatorit ekonomik mbi vlerën e parashikuar te kontratës konkretisht ne vlerën: **558,800.00 Euro**. Bazuar ne Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponushmërisë së fondeve te datës 07.06.2022 nënshkruar nga ZPP, ZKF dhe ZKA vlera e parashikuar ne DNPDF është: 500,000.00 €, e cila është publikuar ne platformën elektronike e-prokurimi me date 07.06.2022, që do të thotë se AK

rrezikon te hyjnë ne marrëdhënie kontraktual pa pasur mjete te zotuar/buxhetore për këtë AP – kontratë. Në sqarimi e kërkuar përmes e-mail-i, lidhur me këtë çështje nga ESH te datës 01.07.2022, ZPP përmes e-mail-i, bashkëngjijt një shkresë si ne vijim:



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
 Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universiteti
 Klinikci Centar Kosova – University Clinical Center of
 Kosovo

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:	Nezafete Cenaj ,ZKF e Sp.të Pejës.		
CC:			
PËR MES/PREKO/THROUGH:	Dr.Valbon Krasniqi,Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUKA		
NGA/OD/FROM:	Sherif Bytyqi,u.d.ZKF i SHSKUK.		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Konfirmim për mbulimin e mjeteve shtesë buxhetore për paisjen mjeksore MRI.		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date: 01.07.2022.

Në bazë të kërkesës së juajë datë 01.07.2022,ju konfirmojm se pjesa e mjeteve shtesë prej 58.800.00€ për furnizimin e MRI do te mbulohet nga Investimet Kapitale I programit 11320-Administrata e Qendrore e SHSKUK nga projekti nr.18235-“Blerja e Paisjeve Mjeksore për Njësit Përbërse të SHSKUK”.

Me respekt.

Prandaj, bazuar ne **nenin 9 par. 5 te LPP-së**, po citoj: “Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një “Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve”. Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1. të këtij neni, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstion se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2. të këtij neni, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga paragrafit 3. të këtij neni, për /pritjet e autoritetit kontraktues në lidhje me

përvetësimet e ardhshme” të cilin ZKA dhe ZKF e përdorin për përmbushjen e kërkesave të këtij neni. AK – ZPP, ZKF dhe ZKA ne momentin e nënshkrimit të DNVDF me date 07.06.2022, nuk kane siguruar fonde te mjaftueshme për te ekzekutuar/realizuar këtë kontratë dhe për te hyre ne marrëdhënie kontraktuale me OE e rekomanduar për kontratë

Po ashtu, bazuar ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ZPP te datës 14.06.2022, tek arsyetimi mbi refuzimin e pretendimeve te OE ankues, po citoj: *“Ju keni pas mundësin që të ofertoni me tri llojet tjera te rezonancës ma te avansuara të prodhuesi Philips (Ingenia Ambition, Ingenia Evolution , Ingenia CX) pse nuk keni ofertuar me një të këto që janë ma te avansuara po keni ofertuar me Rezonancë me specifika me të ulta për me dal çmimi me i ultë. Me specifikat e kërkuara nga AK ka mundur te ofertojnë shumë kompani tjera me prodhues te ndryshëm (P.Sh. SIEMENSI “:modeli SIEMENS SOLA, SIMENS ALTEA, GENERAL ELECTRIC modeli ARTIST, Opt.MR450w1,Voyager, PHILIPS : modeli Ingenia Ambition, Ingenia Evolution , Ingenia CX , Canon : Vantage Orian , Vantage Titan, Fujifilm: modeli Echelon Oval, United Imaging modeli: uMR 580, UMR 588, UMR 560 etj...”*. Duke marr parasysh rrjedhën dhe analizën për këtë AP, konsideroj se njësia e kërkesë kur ka hartuar specifikimin teknik lidhur me këtë pajisje ka qene ne dijeni se me këto specifikime teknike si ne aneksin 1 të FDT-së, kjo pajisje Rezonanca Magnetike (MRI) ka çmimin kushtues më të lartë se sa vlera e parashikuar, që do të thotë se kjo e ka kufizuar konkurrencën ne kundërshtim me **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”*., si dhe OE ankues qe te tenderoj me një model i cili është brenda vlerës se parashikuar, sepse sikur ta dinte se do te rritej vlera e parashikuar apo sikur te ishte më e lartë vlera e parashikuar e kontratës për këtë AP, sigurisht do te tenderonte me njërin nga llojet e specifikuar ashtu sikurse me larat që ka specifikuar AK –ZPP – Njësia e Kërkesës, dhe sigurisht do te tenderonin edhe OE tjerë ne këtë aktivitet te prokurimit, qe do te thotë se njësia e kërkesës e njeh shumë mirë këtë pajisje dhe ka planifikuar vlerën e parashikuar, pusht çmimit kushtues te tregut, apo/ose ka rritur specifikimimet teknike mbi vlerën e parashikuar qe do te thotë se AK nuk ka vepruar ne pajtim te plote me nenin 9 të LPP-së dhe ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Gjithashtu, AK gjate ushtrimit te aktiviteve te prokurimit gjithmonë duhet ta mbajnë mend qëllimin e këtij ligji te përcaktuar ne nenin 1, 6 të LPP-së, si dhe te veprojnë ne përputhje me me **nenin 24 par. 2 të LPP-së**, po citoj:

“Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë të qëndrueshëm**.

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar ne tërësi nenin 1, 6, 7, 59 dhe 62 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP**, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e grupit te OE: “**Uni-care**”sh.p.k.- **Prishtinë, aprovohet si e bazuar**, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK(*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të **Anulohet** - anulimin e aktivitetit të prokurimit sipas **nenit 62 të LPP-së**, dhe nëse akoma ka interesë AK mund ta **ri-tenderoj** dhe te veproj ne përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04.07.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datën 06.07.2022 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 07.07.2022 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.08.2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së se ankuese “UNI – CARE SH.P.K” z. Bajrami i cili deklaroi citat: “ Ne si kompani nuk pajtohemi plotësisht me ekspertin shqyrtues, një ndër arsyet është se kemi ofruar një produkt i cili i plotëson dhe i tejkalon specifikat teknike të kërkuara nga AK dhe që është nën buxhetin e përcaktuar nga AK.”

Pika kryesore ku ne kemi eliminuar është emri i pajisjes që kërkohet 95 kanale për arsye se këtë pajisje e prodhon vetëm një prodhues në botë, ndërsa prodhuesi jonë ofron teknologji tjetër që është më e avancuar që quhet Fiber Optik dhe nuk është e varur nga kanalet dhe nuk mund të krahasohet me këtë produkt.

Kemi edhe disa fakte që i dorëzon ne seancë .

Krejt çka kemi dashur është që ta ofrojmë një produkt që është i mirë edhe për vete.

Te pjesa e ftohësit (chiller) që është shumë e rëndësishme sepse pajisja nuk punon pa të nuk është ofruar as katalog as lloji i chillerit që ofrohet. Produkti që kemi ofruar është ekuivalent dhe më i mirë sesa që është kërkuar.

Është edhe ni pjesë qe nuk pajtohem, te pika ku eksperti ka pretenduar që kompania jonë nuk e ofron prerjen 2/D OSE 3/ D, është kerkuar 0.1 dhe 0.5 mm që këtë produkt e ofron vetëm një prodhues që nuk ka ndonjë ndikim në imazh apo në kualitet të rezonancës magnetike.

Edhe një pikë qe nuk pajtohem me ekspertin ku ka kerkuar të bëhet anulimi në pikën zero nuk pajtohem sepse unë kam ofruar një çmim që është ekspozuar dhe automatikisht dëmtohem në rast të tenderimit se nuk mundem ta ofrojë çmimin e njëjtë. Qëndroj prapa pretendimeve te mia.”

Ne vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së znj. Kelmendi, e cila deklaroi, citat: “Oferta e OE ankues për mua është e pa përgjegjshme te kushtet kapacitetet teknike dhe profesionale. Te kërkesa e dytë AK ka kërkuar deklarata për specifikacion teknik për mallrat e ofruara nga prodhuesi dhe katalogu i prodhuesit , evidec ofertuesi është i obliguar që të dorëzojë një deklaratë nga prodhuesi për specifikime teknike të evidentuara dhe kërkuara për pajisjen në të cilën oferton (të evidentojë me kohë ose jo për secilën specifik teknike te kërkuar varësisht se a e plotëson apo jo këtë specifikë) si dhe duhet te bashkëngjitet katalogu i prodhuesit për pajisjen me të cilën oferton ,ku OE është i obliguar që të nënviozojë specifika teknike në katalog .Këtë dokument OE ankues nuk e ka dëshmuar dhe nuk e ka dhanë .Katalogun edhe këto qe i prezanton OE ankues nuk janë në dosje të tenderit të prezantuar në dosje ,ndërsa sa i përket mjeteve qe thotë OE ne e kemi dit qe 500.000 nuk mjafton për , e kemi prezantu edhe me vërtetimin qe kemi prej SHSKUK .
Është kërkuar një rezonancë magnetike me 95 kanale ndërsa OE ankues ka ofertuar me rezonancë magnetike me 24 kanale.

Kemi edhe prova për mjetet e dorëzaura pranë PSH që kemi edhe nënshkrimet nga zyrtari financiar. Për specifika te njëanshme, kemi edhe prodhues të ndryshem qe kanë plotësuar këtë kërkesë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Beqiri i cili deklaroi, citat:

Të gjitha pretendimet OE i kam sqaruar në ekspertizën në mënyrë të detajuar kjo është oferta e juaj që keni ofertuar me 0.5 mm kur është dashur të ofertohet me 0.1 mm për pikën 2.11 të Aneksit 1 të FDT-së .Sa i përket këtij pretendimi është sqaruar në bazë të rregullores RRUOPP .

Sa i përket pretendimeve tjera edhe me sqarime ,ka dhënë AK se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një deklaratë për pajisje tjera mbeshtetëse të nevojshme për funksionalizimin e rezonancës .

Ndërsa sa i përket pjesës që ky aktivitet i prokurimit duhet te anulohet ,AK rrezikon nenin 24 pika 3 dhe në bazë te rregullores 01/2013 të MF e hyn ne obligime kontraktuale pa mbulesë te mjeteve .Gjithashtu AK e ka e njeh mirë këtë produkt gjatë prezantimit ,e sqaroj se vlera është shumë e ulët. Duhet te aprovohet si e bazuar ankesa dhe rekomandoj të anulohet aktivitetit i prokurimit sipas nenit 62, që thotë se aktiviteti i prokurimit anulohet kur tejkaloen mjetet .

Ndërsa përfaqësuesi i AK -së kërkoi që vendimi i AK të mbetet ne fuqi .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Oferta e operatorit ekonomik ankues është e pa përgjegjshme dhe nuk i plotëson njërin prej kriterëve minimale të kualifikimit, pasi qe i mungon “*Deklarata për specifikacionin teknik për mallrat e ofruara nga prodhuesi dhe katalogu i prodhuesit.*” (OE ankues e nënshkruan dhe plotësona vet këtë deklaratë), ndërsa ne katalogun e ofruar nga prodhues për piken 2.11 te specifikacioni teknike Aneksi 1 te FDT-se, ka ofruar vlerën: 0.5 mm, ndërsa kërkesa ka qene ne vlerë: 0.1 mm, po ashtu piken 4.10 ka ofruar 2 connectors, sikurse ne përgjigjen më lartë të lejuar nga AK me 2 connectors, mirëpo nuk ka ofruar minimum prej mbi 80 kanale, por ka ofruar vetëm: 24 Channels.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve tjera ankimore për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, të gjitha ato janë të pabazuara, ku edhe vetë operatori ekonomik ankues pajtohet me mendimin e ekspertit sa i përket konstatimeve të tij.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform neneve 59 dhe 60 të LPP-së.

Mbete përgjegjësi e autoritetit kontraktues që para nënshkrimit të kontratës të siguroj mjetet shtese për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Spitali i Përgjithshëm”-Pejë.
- 1x1 OE ankues – “Uni-Care” sh.p.k. -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Vedat Poterqoi

